



HISTORI SUKSESI

OFRIMI I KUJDESIT PËR FËMIJËT E ISH-VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT NË QENDRAT DITORE ALTERNATIVE

Alternativat e kujdesit pas shkollor "Shtëpia e gjyshes / Shtëpia tjetër" në Shkozë (Tiranë) dhe Shkodër, menaxhuar nga organizata "Të Ndryshëm dhe të Barabartë", funksionojnë si qendra ditore që ofrojnë kujdes për fëmijët e nënave, viktimat të trafikimit dhe dhunës në familje përtej orarit zyrtar të qendrave të kujdesit publik, nga e hëna në të shtunën. Si një shërbim komunitar, qendrat përzgjidhen me kujdes për të qenë sa më afër familjeve të fëmijëve dhe sa më lehtë të arritshme prej tyre. Për të shkurtuar distancën midis kujdesit alternativ dhe familjeve të fëmijëve, shërbimi siguron transport të sigurt për fëmijët nga kopshti/ çerdhja në qendër dhe kthimin në shtëpi.

Shërbimet e ofruara në këto qendra janë:

Kujdesi dhe mbikëqyrja; higjena dhe shëndeti; ushqimi; lojërat për fëmijë; vlerësimi dhe mbështetje psikologjike etj.



- Dikur vajza ime ishte shumë e ndrojtur dhe nuk fliste, por tani që ajo po frekuenton qendrën e kujdesit alternativ ajo ka filluar të flasë dhe të ndërveprojë me fëmijët e tjerë. Tani punoj e qete dhe ndihem shumë mirë

- shpjegoi M.L., nëna e një vajze

Fëmijët në këto qendra janë aktivë në shumë aktivitete që organizohen me kujdes nga mësuesit. Njëkohësisht vëmendje e veçantë i kushtohet nevojave arsimore dhe zbavitëse të fëmijëve (sipas moshës së tyre). Fëmijët që frekuentojnë shkollën janë mbështetur çdo ditë nga mësuesit për të përgatitur detyrat e shtëpisë, duke i përmirësuar ndjeshëm rezultatet e tyre.

-Unë jam e qetë në punë që nga momenti që fëmijët e mi filluan të vijnë në qendrën e kujdesit alternativ

- thotë P.P. nënë e dy fëmijëve.